



Turgut OZal

BULETINI



PËRMBAJTJA

1. Videoklipi për Festat e Nëntorit
2. Muaji i Historisë
3. Me Zërin e Zemrës për Ty, e Shtrenjta Ime Shqipëri!
4. Vizitë në Kuvendin e Shqipërisë
5. Klasa e 9E në Gjykatën e Rrethit Tiranë
6. Vizitë në Presidencë
7. Klasa e 9G në Ministrinë e Bujqësisë
8. Klasa e 9A në Bashkinë e Tiranës
9. Në studiot e televizionit Channel One
10. Vizitë në Ambasadën Amerikane
11. Seminari i parë i Klubit Shpresa për vitin shkollor 2017-2018
12. Panairi i Ushqimeve
13. Përmbillet Maratona e Panaireve Ushqimore
14. Klubi Shpresa ndihmon Shoqatën e Fëmijëve me Aftësi të Kufizuara dhe 40 familje në nevojë
15. Klubi Shpresa në Institutin e Nxënësve që Nuk Dëgjojnë
16. Thirrje për ndihmë të familjeve të prekura nga përmbytjet
17. Në ndihmë të familjeve të përmbytyra
18. Klubi Shpresa donacion për shkollën 9-vjeçare “Tahir Sinani”
19. Klubi Shpresa dhuron ndihma për fshatin Bubq në Fushë-Krujë
20. Klasat e 3-ta në Institutin e Nxënësve që Nuk Dëgjojnë
21. Klasa e 9A në Amurt Albania Center
22. Të dhurosh libra është dyfish bujari
23. Kontribut për shkollën “Ardian Klosi”
24. Ndihmojmë një familje në nevojë
25. Klubi Shpresa me klasat e teta
26. Vizitë në fermën e Blerina Bombaj Troci
27. Në fabrikën e këpucëve
28. Klasa e 7F vizitë në fabrikën e Coca-Cola
29. Klasat e 4-ta vizitë në fabrikën e Coca-Cola
30. Piknik te kodrat e liqenit me fëmijët e parashkollorit
31. Shëtitje e grupeve të dyta të kopshtit në Kopshtin Zoologjik
32. Një pasdite në Paintball
33. Klasa e 5-të F vizitë në shtëpinë e Sali Shijakut
34. Klasat e para, shëtitje në Pezë
35. Klasat e dyta e të treta, ekskursion në Pezë
36. Shëtitje në Parkun Kombëtar të Llogarasë
37. Klasat e 7G dhe e 8A ekskursion në qytetin bregdetar të Durrësit

Klubi i Medias

Drejtori
Selman Fettahoğlu

Kryeredaktore
Imelda Prence

Redaktorë
Erjona Saqe
Elda Rrustemi
Esmeralda Dibra
Enkelejda Velo

Nxënës
Enisa Dalipi
Gea Ivanaj
Megan Duraj
Sara Xholi
Rebeka Sharko
Engjëllushe Basha
Vivien Shkodra
Era Metaj
Suada Xholi
Amabel Kola
Amelia Duxha
Sidrit Pashako
Sidrit Rrustemi

Fotograf
Lulëzim Marra

Dizajn
Dorjan Pitani

ADRESA
Rruga “Bernardin Palja”
Ndërtesa 15, Hyrja 1
Njësia Bashkiake Nr.6
Tiranë – Shqipëri

TEL: +355 42 486-666
FAX: +355 42 486-666
info@turgutozal.edu.al

TURGUT ÖZAL

19

TIRANË



38. Shëtitje në Llogara me vajzat e klasave të nënta
39. Klasa e 9D te Fushat Multisportive në Parkun e Madh të Liqenit
40. Shkolla dimërore në Londër
41. Nxënësit e ciklit fillor në kinema
42. Udhëtim në Kroaci
43. "Tirana jonë"- projekti i klasave të treta
44. Ekskursion në Dajt
45. Muaji i Artit dhe Letërsisë
46. Konkursi i Kompozicionit
47. Konkursi i Interpretimit
48. Konkursi i Artit Skenik
49. Konkursi i Vizatimit
50. Konkursi i Veglave Muzikore
51. Finalja e Konkursit të Këngës
52. "Takohemi për një libër" me shkrimtarin, përkthyesin, publicistin Edmond Tupja
53. Panairi i 20-të i librit
54. Festivali i Kërcimit nga Vende të Ndryshme të Botës
55. Finalja e konkurseve për Muajin e Artit dhe Letërsisë
56. Kesler Mziu përfaqëson denjësisht në finalen e Kangaroo Global Linguistic
57. Olimpiada Cogito
58. Oxford Placement Test
59. Aptis Teens në kolegjin "Turgut Òzal"
60. Parapërgatitje për GDS
61. Provimet e GDS-së
62. Olimpiada Ndërkombëtare e Matematikës "Noetic"
63. Kampionatet e basketbollit
64. Klubi i Medias
65. Qeveria e Nxënësve
66. Dita Botërore e Ushqimit
67. Dita Botërore e Varfërisë për vitin shkollor 2017-2018
68. Dita Evropiane e Gjuhëve në kolegjin "Turgut Òzal"
69. Dita e Hapur në Luftën Kundër Bullizmit
70. Robotika, lënda më e re mësimore në shkollën tonë
71. Zbavitimi në orën e robotikës me lojën e koduar
72. Klasat e 6-ta mbjellin lule
73. Si të kujdesemi për dhembët
74. Klasat e dyta projektojnë stinën e vjeshtës
75. Shkolla jonë i bashkohet nismës "Të pastrojmë Shqipërinë që duam"
76. Në orën e mësimi të punës me dru
77. Edukohemi përmes Artit dhe Kulturës
78. Lojërat e inteligjencës
79. Sërish në Tangram
80. Mbrëmja Gala

Për reklamimin e produkteve dhe shërbimeve tuaja në buletin tonë, kontaktoni nëpërmjet postës elektronike.





VIDEOKLIPË PËR FESTAT E NËNTORIT

Përcjellja e vlerave patriotike dhe kombëtare ndër breza le të jetë frymëzimi ynë! Për çdo vit, me rastin e Festave Kombëtare të 28-29 Nëntorit, në shkollën tonë realizohet një videoklip, përmes të cilit përcillen gjithnjë e më shumë emocione e vlera në respekt të kombit, nderit e krenarisë kombëtare. Videoklipi i këtij viti “Me Flamurin në Zemër”, i realizuar anembanë Shqipërisë, ku rrjedh gjak shqiptari dhe ku Flamuri Kuq e Zi çon peshë zemrat e shqiptarëve dhe amanetin e brezave, jehon si melodi e shekujve dhe e lirisë.



AKTIVITETE PËR MUAJIN E HISTORISË



MUAJI I HISTORISË

Muaji i Historisë e veshi shkollën tonë Kuq e Zi, me ngjyrat e Flamurit dhe Festave tona Kombëtare. Posterat dhe projektet e ndryshme me tematikë historike, datat e shënuara, figurat tona kombëtare, simbolet kombëtare dhe pamje të ndryshme nga Shqipëria u vendosën në stendat, korridoret, klasat dhe ambientet e shkollës. Një vend të rëndësishëm në këto projekte zë figura e Heroit Tonë Kombëtar, Skënderbeut. Nxënësit, me shumë dashuri dhe përkushtim, kanë derdhur në këto punime e projekte njohuritë, talentin dhe dashurinë që ata kanë për atdheun e vendin e tyre.



KËNDOJ ME ZËRIN E ZEMRËS PËR TY, E SHTRENJTA IME SHQIPËRI!

Festat e 28 dhe 29 Nëntorit, si për çdo vit jehojnë madhërishtëm në shkollën tonë. Përmbyllja e aktiviteteve të muajve të Letërsisë, Artit dhe Historisë, nuk mund të jetë më bukur se me koncertet festive kushtuar këtyre datave.



VIZITA NË INSTITUCIONE SHTETËRORE



VIZITË NË KUVENDIN E SHQIPËRISË

“Unë dhe Parlamenti im”, ishte motoja që shoqëroi nxënësit e klasës së 3A gjatë vizitës në Kuvendin e Shqipërisë. Nxënësit e shkollës sonë u ftuan në këtë institucion që të njiheshin nga afër me funksionin e Parlamentit dhe historikun e godinës së Kuvendit.

Për disa minuta, fëmijët zunë vend në karriget e deputetëve dhe anëtarëve të qeverisë duke diskutuar se çfarë do të bënin ata sikur të ishin në rolin e ministrave apo deputetëve. Megjithëse të vegjël, mendimet e tyre të çiltra dhe mjaft të vyera, lanë mbresa të veçanta te përfaqësuesit e pranishëm të parlamentit.



KLASA E 9E VIZITË NË GJYKATËN E RRETHIT TIRANË

Në vijim të aktiviteteve mësimore për të njohur institucionet, klasa e 9E, vizitoi ambientet e Gjykatës së Rrethit Tiranë. Pasi vizituan disa nga ambientet e gjykatës, nxënësit hynë në një sallë, në të cilën zhvilloheshin gjyqe civile. Aty u njohën më nga afër me mënyrën se si funksionon një proces gjyqësor, me pjesën e bukur dhe vështirësitë e këtij profesioni. Nxënësit u njohën gjithashtu me veprat penale dhe penalitetet, për të cilat mund të dënohet një adoleshent i kësaj moshe. Ata patën mundësinë të improvizonin një seancë gjyqi. Disa prej tyre u bënë pala e paditur, disa pala paditëse, tre nxënës morën rolin e gjykatësve dhe pjesa tjetër ishin dëshmitarë, juri, vëzhgues e të pranishëm në sallë.



VIZITË NË PRESIDENCË

Streha e Parë Vorfnore, Rugëtim i Humanizmit Shqiptar.

“Të bëjmë përpjekje të përbashkëta që fëmijët pa përkrahje prindërore të rriten të shëndetshëm, të edukuar dhe arsimuar, të ndiejnë ngrohtësinë e shtetit dhe të shoqërisë”, u shpreh Presidenti Meta në veprimtarinë “Java e Fëmijëve pa Përkrahje Prindërore”, e organizuar në Presidencë, ku ishin të ftuar dhe morën pjesë anëtarë të Klubit Shpresa dhe senatorët e shkollës sonë, të shoqëruar nga mësues dhe përfaqësues të drejtorisë.

KLASA 9G VIZITË NË MINISTRINË E BUJQËSISË

“Mësimi më i rëndësishëm i botës”

Në kuadër të aktiviteteve që zhvillohen për të shënuar Ditën Botërore të Ushqimit, ditë që këtë vit i kushtohet ushqimit dhe migracionit, nxënësit e klasës së 9G të shkollës “Turgut Ozal” zhvilluan në Ministrinë e Bujqësisë një takim me temë “Mësimi më i rëndësishëm i botës”. Përmes këtyre diskutimeve mbi Ditën Botërore të Ushqimit dhe Qëllimet e Zhvillimit të Qëndrueshëm të OKB-së, United Nations promovojnë dialogun mbi çështjet e ushqimit dhe migracionit në nivel ndërkombëtar.

Nxënësit tanë shprehën dëshirën për të qenë pjesë e programeve vullnetare, që kjo organizatë ka në vende të ndryshme, ide, e cila u pëlqye mjaft nga organizatorët.



KLASA 9A NË BASHKINË E TIRANËS

Nxënësit e klasës së 9A zhvilluan një takim me Kryetarin e Këshillit Bashkiak, Z. Aldrin Dalipi, në Këshillin Bashkiak të Tiranës. Në këtë takim, Z. Dalipi i informoi nxënësit për funksionin e Këshillit Bashkiak. Më pas nxënësit i drejtuan pyetje të ndryshme dhe pas kësaj ata vetë morën rolet e anëtarëve dhe Kryetarit të Këshillit, duke improvizuar një mbledhje të Këshillit Bashkiak, duke propozuar ligje dhe duke votuar pro, kundër, abstenim.





VIZITË NË STUDIOT E TELEVISIONIT CHANNEL ONE

Nxënësit e klasës së 4G vizituan studion e lajmeve në kanalin televiziv Channel One. Me zërat e tyre, fëmijët gjallëruan këtë ambient duke u bërë pjesë e një edicioni lajmesh. Nuk është hera e parë që kjo studio vizitohet nga nxënësit e shkollës "Turgut Özal", por këtë herë ishte një ftesë nga drejtuesi i emisionit, Z. Roland Qafoku. Aty nxënësit u njohën më nga afër me procedurat e përpunimit dhe transmetimit të lajmeve në kohë reale.



VIZITË NË AMBASADËN AMERIKANE

Në kuadër të aktivitetit “Meet America”, Drejtoria e shkollës “Turgut Özal” në bashkëpunim me Ambasadën Amerikane zhvilluan një vizitë në ambientet e këtij institucioni, ku patën një takim me Ambasadorin Amerikan në Shqipëri, Z.Donald Lu. Nxënësit u pritën në sallën e konferencave, ku u njohën me historinë e krijimit të këtij institucioni. Ambasadori iu përgjigj pyetjeve të nxënësve dhe iu tregoi rreth pasioneve të tij. Ai u zbuloi atyre se kur kishte qenë i vogël, ëndrra e tij kishte qenë të bëhej astronaut. “Jam i sigurtë se brezi juaj do ta bëjë Shqipërinë një vend më të mirë”, ishin fjalët përmbyllëse dhe mesazhi që ambasadori iu përcolli fëmijëve.



AKTIVITETET E KLUBIT SHPRESA



SEMINARI I PARË I KLUBIT SHPRESA PËR VITIN SHKOLLOR 2017-2018

Seminari i parë i Klubit Shpresa, në të cilin morën pjesë përfaqësuesit përkatës për secilin paralel dhe secilën klasë, i njohu pjesëmarrësit me objektivat e synuara për këtë vit, ndër të cilat përmenden ndihmat e planifikuara në 2 shkolla dhe kopshte publike, në Spitalin Pediatrik, në Shoqatën e Jetimëve, në Shoqatën e Fëmijëve me Aftësi të Kufizuara dhe disa aktivitete të planifikuara për "Fundjavë ndryshe".

PANAIRI I USHQIMEVE

"Të ndihmosh dhe të sjellësh sadopak ndryshim në jetën e dikujt, fal lumturi e shpresë. Të dhurosh, të jep më shumë kënaqësi se të marrësh!"

Panairi i Ushqimeve është një nga aktivitetet më humane, i zhvilluar nga përfaqësuesit e Klubit Shpresa në bashkëpunim me Drejtorinë e shkollës dhe prindërit e shkollës sonë.

Ky organizim kërkon aktivizimin vullnetar të të gjithë nxënësve për grumbullimin e sa më shumë të ardhurave, me anë të shitjeve të produkteve të ndryshme ushqimore, në mënyrë që t'u vijë në ndihmë njerëzve në nevojë.



PËRMBYLLET MARATONA E PANAIREVE USHQIMORE

Aktiviteti i panairëve ushqimorë u zhvillua nga klasat 1-9 dhe u finalizua nga grupet e kopshtit. Panairi ka arritur të mbledhë një sasi të konsiderueshme të ardhurash, të cilat do të shkojnë në ndihmë të disa shoqatave. Nxënësit pjesëmarrës u impenjuan në maksimum për ta bërë sa më frytdhënëse shitjen e ushqimeve.



KLUBI SHPRESA NDIHMON SHOQATËN E FËMIJËVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA DHE 40 FAMILJE NË NEVOJË

“Të falim një buzëqeshje në fytyrat ku mungon, të sjellim një rreze dielli që të ngrohë aty ku ajo nuk arrin dot.”, është ky misioni fisnik që ka Klubi Shpresa.

Falë ndihmave të mbledhura nga Panairi i Ushqimeve, Klubi Shpresa i erdhi në ndihmë “Shoqatës së Fëmijëve me Aftësi të Kufizuara” dhe rreth 40 familjeve në nevojë në qytetin e Tiranës. Këto ndihma u shpërndanë në formën e pakove, ku secila prej tyre përmbante 15 kg ushqime, miell, sheqer, makarona, oriz, vaj etj.

Aty ku Klubi Shpresa mbërriti, fjalët falenderuese erdhën më së miri nëpërmjet syve të qeshur, shtrëngimeve të duarve dhe urimeve që buronin nga zemra.



KLUBI SHPRESA NË INSTITUTIN E NXËNËSVE QË NUK DËGJOJNË

Një nga aktivitetet më emocionuese të nxënësve të Klubit Shpresa, ishte vizita në Institutin e Nxënësve që Nuk Dëgjojnë. Ndihamat, të cilat konsistojnë kryesisht në mjete shkollore, u mundësuan me anë të fondeve të mbledhura gjatë Panairëve të Ushqimit. Nxënësit u pritën krahëhapur nga të gjithë fëmijët e vegjël, të gëzuar nga ardhja e miqve. Anëtarët e Klubit Shpresa mësuan emrin e tyre në gjuhën e shenjave dhe u kthyen në shkollë me një eksperiencë të re, të ndërgjegjësuar duke kuptuar se pamundësitë mund të jenë një pengesë e vogël, por kurrë nuk do ta pengojnë rrugën e fëmijëve që takuan, drejt një jete të lumtur.



THIRRJE PËR NDIHMË TË FAMILJEVE TË PREKURA NGA PËRMBYTJET

“Thirrja për ndihmë të familjeve të prekura nga përmbytjet,” është një nga nismat e ndërmarra nga Klubi Shpresa. Kësaj thirrjeje iu përgjigjën me shumë devotshmëri të gjithë nxënësit e shkollës sonë, duke sjellë ushqime dhe batanije, të cilat iu shpërndanë familjeve të përmbytura nga përfaqësuesit e Klubit Shpresa.



NË NDIHMË TË FAMILJEVE TË PËRMBYTYRA

Klubi Shpresa nuk e ndërpret punën e tij të vyer për asnjë moment. Këtë herë nxënësit e tij u angazhuan në solidarizimin dhe shpërndarjen e ndihmave për familjet e prekura nga përmbytjet. Klubi udhëtoi drejt fshatit Laknas, në Bashkinë e Kamzës, ku në bashkëpunim me Kryetarin e Bashkisë, Z. Xhelal Mziu dhe stafin e tij, u bë e mundur gjetja e 48 shtëpive të përmbytura dhe shpërndarja e ndihmave në secilën prej tyre.



KLUBI SHPRESA DONACION PËR SHKOLLËN 9-VJEÇARE “TAHIR SINANI”

“Kjo shkollë është hapur që në vitin 2002, pra ka rreth 15 vite si shkollë. Nuk ka asnjë lloj investimi në bazë materiale, përse i përket shkollës sonë dhe donacioni që u bë nga nxënësit e Kolegjit ‘Turgut Ozal’ është një ndër donacionet më të rëndësishme.” Kështu u shpreh Z.Thanas Anastasi, drejtori i shkollës 9 - vjeçare “Tahir Sinani”, në Paskuqan, kur përfaqësuesit e Klubit Shpresa të shkollës sonë i dhuruan kësaj shkolle 50 karrige nxënësish, 15 tavolina nxënësish, 1 tavolinë dhe 1 karrige mësuesi, duke kompletuar kështu një klasë, bibliotekën e shkollës dhe kabinetin e informatikës. Kjo veprimtari e Klubit Shpresa është vazhdim i shumë veprimtarive të bamirësisë që Klubi Shpresa është duke ndërmarrë, sajë vullnetarizmit që tregojnë nxënësit tanë.



KLUBI SHPRESA DHURON NDIHMA PËR FSHATIN BUBQ NË FUSHË-KRUJË

Në ndjekje të misionit të tyre fisnik, nxënësit përfaqësues të Klubit Shpresa, të klasave të 6-ta dhe të 7-ta, udhëtuan drejt fshatit Bubq të Fushë – Krujës, për të qenë pranë familjeve të dëmtuara nga shirat e shumtë të ditëve të kaluara. Si çdo herë tjetër, Klubi Shpresa shpërndau një numër të konsiderueshëm ndihmesh, saktësisht 110 kuti dhe batanije. Sigurisht e gjithë merita shkon për nxënësit e shkollës dhe familjet e tyre bujare që sollën shpresë e gëzim në zemrat e këtyre njerëzve.



KLASAT E 3-TA NË INSTITUTIN E NXËNËSVE QË NUK DËGJOJNË



Në prag të festave të fundvitit, nxënësit e klasave 3C dhe 3F organizuan një fushatë për mbledhje lodrash dhe veshjesh për fëmijët e Institutit që Nuk Dëgjojnë. Qëllimi kryesor ishte që në ditë festash asnjë fëmijë të mos ndihet i trishtuar apo ndryshe nga të tjerët. Ditën e shpërndarjes së ndihmave secilit fëmijë të institutit iu dhanë të paktën 2 ose 3 dhurata nga vetë nxënësit e shkollës sonë. Edhe pse nuk na falenderuan me fjalë, sytë dhe buzëqeshjet e tyre folën shumë. Pastaj me gjuhën e shenjave na treguan që i kishim bërë të lumtur dhe na mirëprisnin sa herë të dëshironim. Kutitë me veshje u lanë të shpërndareshin nga mësuesit kujdestarë të konviktit, të cilët i njohin më mirë fëmijët e institutit dhe nevojat e tyre.

KLASA E 9A NË AMURT ALBANIA CENTER

Nxënësit e klasës së 9A, të shoqëruar nga mësuesja kujdestare, vizituan Qendrën e Fëmijëve me Aftësi të Veçanta (autikë), në Paskuqan, pikërisht në Ditën Ndërkombëtare të Fëmijëve me Aftësi të Veçanta. Nxënësit grumbulluan një sasi të konsiderueshme të ardhurash, të cilat u shpenzuan për tapete dhe për mjete didaktike. Gjithashtu u shpërndanë dhurata për Krishtlindjet dhe Vitin e Ri.



TË DHUROSH LIBRA ËSHTË DYFISH BUJARI

Edukimi i mendjes pa edukimin e zemrës nuk është asnjëherë i plotë, ndaj me nxënësit e shkollës organizohen aktivitete të shumëllojshme, të cilat e plotësojnë edukimin dhe lënë gjurmë në formimin e tyre akademik e kulturor. Në vijim të bashkëpunimit me Bashkinë e Tiranës për të dhuruar libra për bibliotekat e shkollave të reja të kryeqytetit, këtë herë ishin nxënësit e klasës së 5B, të cilët organizuan dhurimin e 460 librave jashtëshkollorë për shkollën 9-vjeçare të sapondërtuar, "Betim Muço".



KONTRIBUT PËR SHKOLLËN

"ARDIAN KLOSI"

Të kontribuosh në të mirë të arsimit, është ndihmë në të mirën e vendit. Bashkëpunimi më i fundit i shkollës sonë në këtë drejtim, me Bashkinë e Tiranës, ishte një projekt i dobishëm dhe mjaft frytdhënës. Ishin nxënësit e klasës 6E, ata të cilët e realizuan më së miri këtë projekt duke treguar bujari, gatishmëri e seriozitet, cilësi këto që çuan në mbledhjen e librave dhe mjeteve shkollore për shkollën publike të sapondërtuar, "Ardian Klosi".

KLUBI SHPRESA DHE FUNDJAVA NDRYSHE

NDIHMOJMË NJË FAMILJE NË NEVOJË



“Bashkë mund dhe do t’ia dalim”

Klubi Shpresa edhe këtë vit, duke iu bashkuar nismës së fondacionit “Fundjavë Ndryshe”, për të ndihmuar dhe promovuar vlerat humanitare dhe për të qenë pranë familjeve në nevojë, po vijon aktivitetin me temë: “Ndhimojmë një familje në nevojë”.

Në vijim të kësaj nisme nxënësit e klasës së 9G, këtë vit shkuan përsëri në familjen që ndihmuan vitin e kaluar, por gjithashtu ndihmuan edhe një familje tjetër në nevojë.

Po kështu edhe nxënësit e klasës së 9D, morën iniciativën të ndihmonin dy familje në nevojë. Si fillim, ata mblodhën një sasi të caktuar parash. Me këto para ata siguruan ndihma për këto familje. Ky është viti i dytë që nxënësit organizojnë me klasat e tyre këto aktivitete bamirëse në ndihmë të njerëzve në nevojë.

KLUBI SHPRESA ME KLASAT E 8-TA

Një dorë për ndihmë...

Nisma e ndërmarrë nga nxënësit e klasave 8A, 8B, 8C, 8E, 8G dhe 8H, me mbështetjen e prindërve, mësuesve kujdestarë dhe drejtorisë së shkollës, për t’u ardhur në ndihmë familjeve në nevojë, tregoi edhe një herë ndjenjën e humanizmit që mbruhet në shpirtin e tyre dhe që shfaqet vazhdimisht në raste të tilla. Të gjithë së bashku duhet t’i japim dorën njëri-tjetrit për ndihmë, kjo është një domosdoshmëri. Përvoja e takimit me familjet në nevojë është një eksperiencë e çmuar, është një zgjim, që na kujton të kthejmë sytë nga njerëzit që kanë nevojë për mbështetje dhe ndihmën tonë. Shpesh njerëzit më në nevojë janë shumë pranë nesh e ne i harrojmë. Ndonjëherë mjafton fare pak për t’i bërë të lumtur.



VIZITA NË BIZNESE

VIZITË NË FERMËN E BLERINA BOMBAJ TROCI

Nxënësit e klasës së 2C vizituan fermën e dietologes së njohur Blerina Bombaj Troci. Fëmijët panë ndoshta për herë të parë një hapësirë kaq të bollshme plot perime dhe erëza.

Më vonë radhën e kishin lojërat. Fëmijët shijuan gjithashtu ushqimet e shijshme dhe organike të ofruara nga e zonja e shtëpisë dhe u larguan mjaft të kënaqur që kaluan një paradite mbresëlënëse në shoqërinë e Blerinës dhe fermës së saj mikpritëse.



NË FABRIKËN E KËPUCËVE

Fëmijët e klasës së 4E vizituan fabrikën e këpucëve “Rozimpex”. Atje u njohën me llojet e ndryshme të lëkurëve, ngjyrat, cilësinë dhe përmasat e tyre. Vëzhguan me interes prerjen e lëkurëve nëpër makineri, të cilat ishin të tipave të ndryshëm dhe procesin e përgatitjes së një këpuce deri në pjesën e sipërme të saj. Përshtypje u bënë edhe mjetet, materialet shtesë dhe aksesorët bazë që nevojiten në këtë zana.

Duke parë se si punohej në këtë fabrikë, kushtet e punës, uniforma që punëtorët veshin dhe kujdesi që duhet treguar gjatë punës me makineri, fëmijët kuptuan se profesionet e të rriturve mund të jenë sa të bukura, po aq të komplikuar, për faktin se kërkojnë durim dhe impenjim maksimal.



KLASA E 7F VIZITË NË FABRIKËN E COCA-COLA

Në fillim të muajit dhjetor, nxënësit e klasës së 7F, vizituan fabrikën e Coca-Cola në Shqipëri. Ata u njohën nga afër si me historikun e krijimit të Coca-Colës ashtu dhe me procesin e fryrjes së shisheve, mbushjes dhe paketimit dhe më pas magazinimin e tyre. Përshtypjet që morën fëmijët prej kësaj vizite ishin mjaft mbresëlënëse. Ata u ndjenë të privilegjuar dhe më të ditur.

KLASAT E 4-TA VIZITË NË FABRIKËN E COCA-COLA

Në një prej orëve mësimore të klasave të 4-ta, mësueset u kujdesën që nxënësit t'i merrnin dijet në mënyrë të drejtpërdrejtë në fabrikën Coca-Cola. Nxënësit ndoqën me mjaft kureshtje shpjegimin e punonjësve të specializuar. Pas përfundimit të vizitës nxënësit diskutonin hareshëm mbi gjithçka që mësuuan.



SHËTITJE DHE VEPRIMTARI TË TJERA ZBAVITËSE

PIKNIK TE KODRAT E LIQENIT ME FËMIJËT E PARASHKOLLORIT

Shëtitja për tetë grupet e parashkollorit të Kodrat e Liqenit, kishte si synim vëzhgimin nga afër të ndryshimeve që sjell stina e vjeshtës në natyrë. Lojërave zbavitëse që bënin fëmijët, iu bashkuan edhe edukatorët, të cilat herë pas here u mësonin atyre rregullat e ndonje loje të re për ta. Nga entuziazmi që e shprehnin me aq çiltërsi, nuk ishte e vështirë të kuptoje se vogëlushët i duan pafund daljet në ajër të pastër, lulet dhe sidomos argëtimin e bisedat që ndajnë me bashkëmoshtarët.



SHËTITJE E GRUPEVE TË DYTA TË KOPSHTIT NË KOPSHTIN ZOOLOGJIK

Grupet e dyta të kopshtit “Zübeyde Hanım” organizuan një shëtitje në Kopshtin Zoologjik. Fëmijët u lumturuan shumë kur e gjetën veten mes gjelbërimit dhe zërave të kafshëve të këtij pylli të improvizuar. Lama, dhelpira, ariu, demi, delja, dreri e shumë kafshë të tjera ishin objekte eksplorimi për fëmijët për minuta me radhë.



NJË PASDITE NË PAINTBALL



Dukej si një betejë e vërtetë, por në fakt ishte vetëm një ndeshje paintballi mes djemve të klasës së 8B dhe 8C, e zhvilluar pas mësimit dhe e organizuar në ambientet e televizionit Top Channel. Janë të rralla betejat që nuk i ndajnë, por i forcojnë shoqëritë dhe miqësitë dhe kjo ishte një nga këto “beteja”.

KLASA E 5-TË F VIZITË NË SHTËPINË E SALI SHIJAKUT



Nxënësit e klasës së 5F bënë një vizitë në shtëpinë e Sali Shijakut në Tiranë. Aty vizituan ambientin e saj të brendshëm e shijuan rreth 100 piktura të bëra nga ky artist i penelit, i cili kishte reflektuar botën shpirtërore e dinamike të shoqërisë. Ata mësuan shumë fakte rreth kësaj ndërtese shumëvjeçare, që tashmë është e dyzuar në galeri arti dhe restorant tradicional. Ajo është rreth 300 vjeçare dhe i përket viteve 1400. Brenda saj ajo fsheh thesare të bëra nga dora e këtij artisti, që mahnit çdo vizitor.

KLASAT E PARA, SHËTITJE NË PEZË

Shëtitja e nxënësve të klasave të para në Pezë, përveç argëtimit dhe shpłodhjes së fëmijëve, synonte bashkëpunimin e tyre me njëri-tjetrin, ashtu dhe njohjen nga afër me natyrën. Fëmijët zhvilluan lojëra të ndryshme, të tilla si: tërheqje litari, lojëra me top, gara vrapimi etj. Ndarja në grupe shtoi konkurrencën dhe emocionet mes fëmijëve. Të gjithë fëmijët meritonin fitoren, sepse në fund triumfuan buzëqeshjet, përqafimet e ngrohta dhe fjalët e tyre të singerta. Sa bukur janë për fëmijët e vegjël momente të tilla argëtuese!



KLASAT E DYTA E TË TRETA, EKSKURSION NË PEZË

Për t'i shijuar sa më këndshëm ditët me diell të stinës së vjeshtës, nxënësit e klasave të dyta dhe të treta, zhvilluan një ekskursion në Pezë. Të shoqëruar nga mësueset, ngjyrat e buzëqeshjeve, zërat dhe lojërat fëmijërore, përzier me të gjitha refleksat e mundshme të ngjyrave të vjeshtës, kjo shëtitje mori një vlerë mjaft të veçantë. Në këtë ekskursion fëmijët dalluan pemë frutore karakteristike për stinën dhe zhvilluan aktivitete të ndryshme argëtuese.

Vetë fëmijët koleksionuan gjethe të ndryshme të stinës së vjeshtës, duke i marrë me vete si kujtim, së bashku me çastet e mrekullueshme të kaluara me njëri-tjetrin në ajër të pastër.



SHËTITJE NË PARKUN KOMBËTAR TË LLOGARASË



Nxënësit e paraleleve të klasave të 7-ta dhe të 8-ta zhvilluan një ekskursion mjaft emocionues në Parkun Kombëtar të Llogarasë. Përveç shijimit të pamjes së mrekullueshme që ofron natyra e këtij parku, argëtimit dhe zbavitjes me njëri-tjetrin, qëllimi kryesor në këtë ekskursion ishte ngjitja në malin e Llogarasë. Megjithëse rruga që e vështirë dhe e lodhshme, pamja e mrekullueshme prej majës së këtij mali u la mbresa të veçanta “alpinistëve” tanë.

KLASAT E 7G DHE E 8A EKSKURSION NË QYTETIN BREGDETAR



Në sajë të impenjimit maksimal dhe përfaqësimit shumë të mirë në Panairin Ushqimor, nxënësit e klasës së 7G dhe të 8A, zhvilluan një ekskursion në qytetin bregdetar të Durrësit. Në këtë ekskursion fëmijët u ndjenë tejet të gëzuar duke u argëtuar në lojërat përgjatë shëtitores, po ashtu dhe në shoqërinë e njëri-tjetrit.

SHËTITJE NË LLOGARA ME VAJZAT E KLASAVE TË NËNTA

Një shëtitje e paharrueshme u zhvillua në Llogara me vajzat e paralelit të klasave të nënta. Të qeshurat, këndimi dhe kërcimi i shoqëruan vajzat gazmore jo vetëm gjatë gjithë rrugës, por edhe gjatë darkës, së bashku me vallet popullore. Dhe më energjike ishte dita tjetër, akoma edhe më frymëzuese, hiking në malin e Llogarasë. Të gjitha u mrekulluan, kur panë peizazhin që të ofronte maja e malit dhe shkrepën foto të shumta.



KLASA E 9D TE FUSHAT MULTISPORTIVE NË PARKUN E MADH TË LIQENIT

Një aktivitet jo vetëm zbavitës dhe i bukur, por edhe mjaft i shëndetshëm, ishte aktiviteti sportiv i zhvilluar nga klasa e 9D në Fushat Multisportive, në Parkun e Madh të Liqenit. Ky aktivitet u zhvillua me ndihmën dhe bashkëpunimin e Agjencisë së Parqeve dhe Rekreacionit, Bashkia Tiranë. Aktiviteti synonte t'i njihje nxënësit me sporte të reja në natyrë, siç është dhe sporti i Taekwondo-së. Nxënësit, të drejtuar nga një mësues me shumë përvojë dhe katër studentë Taekwondo-je, arritën të bëheshin pjesë e këtij sporti dhe të mësonin disa lëvizje të thjeshta.



SHKOLLA DIMËRORE NË LONDËR



Shkolla dimërore në një prej kryeqyteteve më sharmante evropiane, në Londër, përfundoi aktivitetet e saj mjaft interesante e të larmishme. Shëtitjet atje u organizuan në disa prej pikave turistike më të njohura. Të tilla ishin vizitat në Parkun Kombëtar dhe në Qytetin Kid-zania, një ambient dedikuar totalisht fëmijëve. Nxënësit patën mundësi të shihnin nga afër Pallatin Mbretëror, Hyde Park, Westminster, Trafalgar Square, Kullën e lartë të Big Ben, Syrin e Londrës, lundruan me varkë në lumin Thames, i cili ofron pamje nga i gjithë qyteti dhe vizituan Akvariumin mahnitës të Londrës. Me mjaft interes ishte shëtitja në qytetin e Oksfordit dhe Universitetin e tij, Muzeu Historik Natyral dhe Muzeu i Shkencës, Stadiumi i Arsenalit, Toka e Çudirave Dimërore, Muzeu prej Dylli i Madam Tussauds, ku mund të gesh skulptura prej dylli të njerëzve më të famshëm, kinemaja “Imax” dhe setet ku janë realizuar xhirimet e filmave hit për fëmijë, “Harry Potter” e “Liza në Botën e Çudirave” dhe Qendra Tregtare Westfield.

Ndërthurur me shëtitjet, ditë pas dite, u zhvilluan edhe disa orë mësimi në anglisht, të cilat i thelluan edhe më tepër dijet që këta nxënës kanë marrë në shkollë.





NXËNËSIT E CIKLIT FILLOR NË KINEMA

Të jesh fëmijë është një mundësi që të jepet vetëm një herë në jetë. Janë të paharrueshme sidomos çastet që fëmijët kalojnë me njëri-tjetrin. I tillë ishte aktiviteti i zhvilluar me nxënësit e ciklit fillor në kinema. Nxënësit nga klasa e parë deri në klasën e pestë, në ditë të ndryshme panë filma për fëmijë, përkatësisht filmin “Koko” për më të vegjlit dhe filmin “Wonder” për nxënësit e klasave të pesta. Emocionet dhe gëzimi shiheshin në sytë, në të qeshurat e fëmijëve, të cilët shprehnin më së miri kënaqësinë që ndodheshin në një aktivitet të tillë.



UDHËTIM NË KROACI

Në vazhden e aktiviteteve jashtëshkollore që organizon shkolla jonë, klasat e 4-5-6 zhvilluan një shëtitje në Kroaci. Gjatë rrugës nxënësit shijuan pamjet magjepsëse dhe drekën në qytetin e bukur të Tivarit. Në mbrëmje mbërritën në Dubrovnik. Të nesërmen, nxënësit bënë një shëtitje në qytetin e vjetër të Dubrovnikut dhe u mahnitën me vlerat arkeologjike të qytetit të lashtë. Gjatë pasdites u argëtuan në ambientet e pishinave dhe organizuan disa ushtrime aerobike, gara noti dhe jakuzzi. Gjatë kthimit për në Shqipëri bënë një ndalesë disaorëshe në Kotorr.



“TIRANA JONË”- PROJEKTI I NXËNËSVE TË KLASAVE TË TRETA



Qyteti ku janë rritur është motivi i projektit të realizuar nga nxënësit e klasave të treta. Së bashku me mësueset ata punuan me shumë përkushtim për t'i dhënë formë projektit me temë “Tirana jonë”. Nxënësit përgatitën materiale me informacione rreth trashëgimisë kulturore të Tiranës, ndërtuan modele në miniaturë të disa prej objekteve kulturore më të rëndësishme të Tiranës dhe ekspozuan kartolina me pamje të Tiranës së dikurshme dhe së sotme.

EKSKURSION NË DAJT



Klasa e 6C organizoi një shëtitje për në malin e Dajtit. Argëtimi filloi në parkun e njohur “Adventure Park”, ku nxënësit frekuentuan ajrin e pastër, natyrën malore dhe lojërat e ndryshme. Më pas kënaqësia e një dreke në restorantin “Ballkoni i Dajtit”, me pamje të rralla të qytetit. Gjatë kthimit për në shkollë nxënësit dukeshin të lumtur e bisedonin pa pushim rreth aventurave të ditës.

AKTIVITETE PËR MUAJIN E ARTIT DHE TË LETËRSISË, KONKURSET

MUAJI I ARTIT DHE LETËRSISË

Konkurset e Fjalës Artistike, Krijimit, Këngës, Artit Skenik dhe Artit figurativ, janë nga veprimtaritë më të dashura për nxënësit, me ardhjen e Muajit të Artit dhe Letërsisë.

Motoja “Gjuha mban gjallë shpirtin e një kombi”, shoqëroi aktivitetet kryesore të zhvilluara përgjatë këtij muaji. Klasat, korridoret dhe ambientet e tjera të shkollës u kthyen në ekspozë fantazie shumëngjyrëshe të punëve plot pasion të nxënësve në projekte 3D, postera, portrete, vizatime, albume etj. Takimet dhe bisedat me shkrimtarë për fëmijë dhe personalitete të artit dhe kulturës, qenë po ashtu pjesë e aktiviteteve që janë planifikuar të zhvillohen nga Drejtoria e shkollës dhe Katedra e Gjuhës shqipe dhe Letërsisë.



KONKURSI I KOMPOZICIONIT

Mendimet dhe aftësitë e tyre krijuese nxënësit i shprehën plot ndjenjë në Konkursin e Kompozicionit. Temat kishin si referim perceptimet e tyre në lidhje me dashurinë për atdheun apo gjuhën amtare. Gjithashtu këtë vit, iu la vend dhe trajtimit të fenomenit të bullizmit, për të cilin fëmijët dhanë mendimet dhe opinionet e tyre.

Konkurse të tilla në shkollën tonë kanë si qëllim jo vetëm angazhimin e nxënësve në veprimtari letraro-artistike, por dhe edukimin e tyre me vlera të tilla si: dashuria ndaj gjuhës amtare, respektimi i mendimit të tjetrit apo vlerat e një miqësie të mirë.





KONKURSI I INTERPRETIMIT

Interpretimi, arti i të shprehurit bukur, i cili nxjerr në pah natyrën dhe karakterin e secilit fëmijë, edhe këtë vit solli emocione të pafundme, si te nxënësit, edhe te anëtarët e jurisë. Të gjitha interpretimet ishin vërtet mbresëlënëse. Vargjet dhe fragmentet e përzgjedhura u interpretuan me shumë mjeshtëri nga talentet e shkollës sonë.

KONKURSI I ARTIT SKENIK

Konkursi i Artit Skenik, për klasat e 6-ta, të 7-ta, të 8-ta dhe të 9-ta, u zhvillua mes emocioneve të shumta. Loja e arrirë aktoriale e nxënësve tanë, solli në skenë kryevepra të dramaturgjisë shqiptare e asaj botërore. Tematika ishte e larmishme dhe me vlera artistike dhe edukative. Një risi ishte vënia në skenë e një pjese të shkruar nga vetë nxënësit me tematikë nga jeta e tyre e përditshme, siç është bullizmi.



KONKURSI I VIZATIMIT

Një jetë e mirorganizuar brenda këtij komuniteti të madh nxënësish, u jep mundësi të gjithë fëmijëve të zhvillojnë aftësitë e tyre në çdo fushë të artit.

Nxënësit e klasave të 4-ta e deri në klasat e 9-ta, morën pjesë në Konkursin e Vizatimit, sipas kategorive përkatëse. Talenti u derdh në letër me ngjyrat e shpirtit dhe mori jetë. Motivet e vizatuara, ishin të shumta dhe mbresëlënëse. Punimet ishin të llojeve të ndryshme: me vaj, akualet, bardhë e zi etj. Këto veprimtari janë nxitje drejt artit dhe kultivojnë dëshirën që nxënësit të rriten artistikisht e të jenë të gjithanshëm.



KONKURSI I VEGlave MUZIKORE

Muzika, arti që pasqyron jetën dhe shpreh ndjenjat e mendimet me anë të tingujve, vjen në shkollën tonë dhe përmes konkursit të veglave muzikore, i cili u realizua për herë të parë në kolegjin "Turgut Ozal". Ky konkurs synon përzgjedhjen e nxënësve më të talentuar, të cilët do të jenë pjesë e bandës muzikore të shkollës sonë. Disa nga veglat muzikore në të cilat u konkurrua janë: piano, kitarë, bateri, violinë, fyell etj. Performanca e të gjithë nxënësve pjesëmarrës në këtë konkurs ka qenë mjaft e lavdërueshme.



FINALJA E KONKURSIT TË KËNGËS

Një nga aktivitetet më emocionues të Muajit të Artit dhe Letërsisë, është dhe Konkursi i Këngës. Zëra të fuqishëm, të ëmbël, shumë melodioz, të gjithë në harmoni të plotë, mbushën e ngritën peshë skenën e shkollës, duke vënë në vështirësi përzgjedhjeje edhe vetë jurinë. Një buqetë urimesh për të gjithë finalistët!





“TAKOHEMI PËR NJË LIBËR” ME SHKRIMTARIN, PËRKTHYESIN, PUBLICISTIN EDMOND TUPJA

“E vizitova me kureshtje dhe kënaqësi institucionin arsimor, edukativ e kulturor ‘Turgut Ozal’ dhe për herë të parë e pashë veten në një muzeum të tillë monumental në të mirë të të rejave dhe të të rinjve të vendit tim...”, kështu u shpreh profesor Edmond Tupja, gjatë një takimi të zhvilluar me nxënësit e shkollës sonë dhe pasi vizitoi ambientet e shkollës sonë.

Ky aktivitet u organizua nga Drejtoria e shkollës dhe Katedra e Gjuhës Shqipe në bashkëpunim me E Drejta e Autorit - Ministria e Kulturës, në kuadër të veprimtarisë “Takohemi për një libër”. Bashkëbisedimi u fokusua në dy vepra kryesore, “Dhimbja që premtonte dashuri” dhe “Mos ik o ma”. U bënë shumë pyetje nga nxënësit rreth këtyre dy veprave, por u fol dhe për çështje të së drejtës së autorit. Ishte kjo një bisedë mjaft e lirshme për librin, artin e të shkruarit, frymëzimin dhe jetën.

PANAIRI I 20-TË I LIBRIT

Panairi i 20-të i Librit, Tirana 2017, u vizitua dhe nga nxënësit e shkollës sonë. Ky Panair është ngjarja më e madhe kulturore në pasqyrimin e veprimtarisë letrare brenda dhe jashtë kufijve të Shqipërisë, i cili jep mundësinë për të gjetur në të njëjtin vend, atë që çdo lexues dëshiron. Sheh, shfleton, zgjedh librin tënd, takon autorin, përkthyesin, botuesin, pasi libri mbetet pasuri që nuk i humbet vlera kurrë!





FESTIVALI I KËRCIMIT NGA VENDE TË NDRYSHME TË BOTËS

Salla e kulturës në shkollën tonë është shpeshherë dëshmitare e talenteve të rralla të nxënësve tanë, por jo vetëm. Sepse ndodh që ajo të presë mysafirë të veçantë, që na nderojnë me praninë dhe angazhimin e tyre në aktivitete të rëndësishme kulturore. I tillë ishte edhe Festivali i Kërcimit me Ansamble nga Vende të Ndryshme të Botës, i organizuar me pjesëmarrjen e kërcimtarëve të grupmoshave të reja të ansambleve nga vende, si: Shqipëria, Kosova, Maqedonia, Bosnje-Hercegovina, Bullgaria, Rumania, Kroacia, Kirgizistani etj. Koreografitë e kërcimeve dhe kostumet popullore ishin unike dhe njëkohësisht përfaqësimi më i denjë i etniteteve përkatëse.



FINALJA E KONKURSEVE PËR MUAJIN E ARTIT DHE LETËRSISË

Më 16 dhjetor, në ambientet e Kolegjit "Turgut Özal" Tiranë u organizua Konkursi i Interpretimit, në Finalen e Konkurseve të Muajit të Artit dhe të Letërsisë, që u zhvillua mes shkollave "Turgut Özal" Tiranë, "Turgut Özal" Durrës, "Hasan Riza Pasha", "Mist" dhe "Mehmet Akif". Gjithsej ishin 166 nxënës që konkurruan mes tyre në fushën e këngës, interpretimit, kompozicionit dhe artit figurativ, të ndarë sipas kategorive përkatëse. Vlerësimi i nxënësve konkurrentë u bë nga një juri profesionale me emra të njohur të skenës dhe kinematografisë shqiptare, si: Irma Libohova, Roven Dilo, Kejsi Tola, Rajmonda Bulku, Mimoza Mevlani dhe Sokol Angjeli.



KESLER MZIU PËRFAQËSON DENJËSISHT NË FINALEN E KANGAROO GLOBAL LINGUISTIC

Kesler Mziu, nxënës i shkollës sonë në klasën e 5-të, kryesoi listën e nxënësve të përzgjedhur për konkursin e Kangaroo, finalja e të cilit është zhvilluar në Greqi. Ky konkurs ndërkombëtar zhvillohet një herë në vit dhe është i hapur për të gjithë nxënësit nga klasa e 3-të deri në klasën e 12-të, pra nga mosha 8-18 vjeç. Kjo ishte hera e parë që në Shqipëri u organizua Olimpiada e Gjuhës Angleze Kangaroo Global Linguistic (KGL).

OLIMPIADA COGITO

Olimpiadat me nxënësit më të talentuar në lëndët si: matematikë, fizikë, biologji, kimi, kompjuter, anglisht dhe turqisht, zhvillohen çdo të shtunë ose gjatë javës mbas mësimit. Në këto olimpiada marrin pjesë nxënës nga klasa e 6-të deri në klasën e 9-të dhe janë afërsisht 170 nxënës të interesuar vetëm nga shkolla jonë, të cilët janë përzgjedhur në bazë të prirjeve në fusha të caktuara. Këto olimpiada do të finalizohen në fund të vitit shkollor në shkollën "MIST", ku zhvillohet faza finale. Nxënësit e klasave të 9-ta, do të kenë mundësinë të marrin pjesë në Olimpadden Kombëtare të Matematikës.





OXFORD PLACEMENT TEST

Oxford Placement Test është një test, i cili teston njohuritë e nxënësve në gjuhën angleze. Ky testim zhvillohet për nxënësit nga klasat e 3-ta deri në klasat e 9-ta, në fillim dhe në fund të vitit shkollor. Metodologjia e përdorur shërben jo vetëm për të testuar njohuritë e nxënësve, por edhe për të ndjekur progresin e tyre përgjatë vitit shkollor, duke i orientuar drejt objektivave që duhet të arrijnë. Nxënësit vlerësohen për njohuritë e tyre në dëgjim e në përdorimin e drejtë të gjuhës dhe në fund marrin një certifikatë, e cila pasqyron nivelin e tyre të anglishtes.

APTIS TEENS NË KOLEGJIN "TURGUT ÖZAL"

"Aptis Teens", është një test i mundësuar nga British Council, i cili shërben për të matur njohuritë e gjuhës angleze në grupmoshat nga 13-17 vjeç. Nxënësit vlerësohen për të gjitha aftësitë në këtë gjuhë. Ky provim u mundëson nxënësve matjen e njohurive të gjuhës angleze në nivel ndërkombëtar dhe të standardizuar.





PARAPËRGATITJE PËR GDS

Vetëm me një “klik” dhe përgjigja është te ju!
Nxënësit kanë mundësi të përsëritin njohuritë përmes web quiz-eve në portalin online, përmes testeve parapërgatitore për GDS-në edhe këto në Portalin online apo përmes Test Yourself. Të gjitha këto modele testesh mund të zhvillohen në portalin online nga shtëpia.

PROVIMET E GDS-SË

Muaji dhjetor është periudha që përkon me zhvillimin e GDS-ve për periudhën e parë të vitit shkollor, ndërsa fundi i muajit prill dhe fillimi i muajit maj është periudha e dytë në të cilën zhvillohen GDS-të. GDS-të janë provime me alternativa, përmes të cilave nxënësit testojnë njohuritë e tyre në lëndë të ndryshme. GDS-të zhvillohen në fletë ose online, nëpërmjet portalit, ku është i regjistruar çdo nxënës dhe mund të hyjë me anën e adresës personale.





OLIMPIADA NDËRKOMBËTARE E MATEMATIKËS "NOETIC"

Në Kolegjin "Turgut Özal" njohurive në lëndën e matematikës u kushtohet një rëndësimjaftëveçantë. Përkëtë, shkolla jonë vazhdimisht është pjesëmarrëse në konkurse dhe olimpiada të niveleve kombëtare dhe ndërkombëtare. E tillë është Olimpiada Ndërkombëtare e Matematikës "NOETIC" e zhvilluar më datë 10 nëntor për të dytin vit radhazi në shkollën tonë. Nëpërmjet kësaj olimpiade, njohuritë e nxënësve në fushën e matematikës maten në nivel ndërkombëtar. Në këtë testim morën pjesë 93 nxënës nga klasat e 4-ta, të 5-ta, të 6-ta dhe të 7-ta nga të cilët, 27 u vlerësuan me Certifikatë Nderi dhe 4 prej tyre dolën fitues skuadre. U urojmë suksese të gjithë nxënësve tanë në konkurse të tjera të këtij lloji!



SPORT VISION



SPORT VISION



Dorëzoni këtë kupon në çdo dyqan Sport Vision
dhe do të përfitoni 20% Ulje në Koleksionin e Ri Spring-Summer 2018

20% ULJE



TEG, QTU, TOPTANI, SHKODËR, DURRËS, FIER, VLORE, SPORT VISION OUTLET MEGATEK

www.sportvision.al



SPORT VISION ALBANIA



SPORTVISIONALBANIA

TE DHE VEPRIMET

**KAMPIONATET E BASKETBOLLIT**

Jeto me sport, jeto shëndetshëm! Aktivitetet sportive janë nga më të dashurat për nxënësit e shkollës sonë. Në to gërshetohen dukshëm aftësia që kanë nxënësit tanë në sporte të ndryshme, bukuria dhe entuziazmi i lojës dhe dëshira për fitore, pra energji, lojë e bukur, emocione! Kampionati i Basketbollit për klasat 7-8-9-të, si për vajzat dhe për djemtë, faza gjysmëfinale u zhvillua në palestrën e shkollës.

MËSOJMË PËRMES PRAKTIKËS

KLUBI I MEDIAS

Klubi i Medias ka vite tashmë që e ka nisur dhe e vazhdon rrugëtimin e tij. Përmes punës dhe pasionit të nxënësve dhe mësuesve, anëtarë të këtij klubi, mundësohet pasqyrimi i aktiviteteve dhe veprimtarive të ndryshme, që zhvillohen në shkollën tonë dhe më gjerë. Media online, buletinët, të cilët botohen dy herë gjatë një viti shkollor, revista "Foleja familjare" etj, janë disa nga jetërsimet e punës së klubit.



QEVERIA E NXËNËSVE

Qeveria e Nxënësve i jep zë mendimit të masës së nxënësve për çështje që lidhen me mbarëvajtjen e shkollës, mësimin dhe edukimin e tyre. Senatorët shprehin jo vetëm mendimet e tyre, por edhe mendimet e të gjithë nxënësve që ata përfaqësojnë. Përveç përfaqësuesve të klasës, në qeverinë e nxënësve është i pranishëm dhe një nëndrejtor ose mësues koordinator, i cili mbikëqyr mbledhjet e senatit. Në këtë qeveri të gjithë nxënësit janë të barabartë, sepse ajo krijohet nga vetë ata me pjesëmarrjen e tyre të lirë dhe punojnë së bashku për të njëjtin qëllim.



DITA BOTËRORE E USHQIMIT

Panairi Ushqimor i klasave të nënta këtë vit përkoi pikërisht me Ditën Botërore të Ushqimit. Ishte mjaft interesante dhe motoja e zgjedhur nga nxënësit: "You can't buy happiness, but you can buy cookies. And that's kind of the same thing." Çdo vit, tema është e ndryshme, por gjithnjë ka për qëllim të sensibilizojë në drejtim të përmbushjes së Objektivave të Mijëvjeçarit për zhdukjen e urisë dhe varfërisë, si dhe uljen e vdekshmërisë dhe përmirësimin e shëndetit mes fëmijëve dhe grupeve vulnerabël.



DITA BOTËRORE E VARFËRISË PËR VITIN SHKOLLOR 2017-2018

Klasat e 6-ta, ishin nga klasat më të privileguara përse i përket ditës në të cilën ato organizuan Panairin Ushqimor. Në rrjedhën e veprimtarisë në ndihmë të familjeve në nevojë, organizimi i panairit për këtë paralel ishte në Ditën Botërore të Varfërisë. Kjo veprimtari u zhvillua me moton: "Edhe pse s'mund ta zhdukim varfërinë, mund ta zvogëlojmë atë".



DITA EVROPIANE E GJUHËVE NË KOLEGJIN "TURGUT ÖZAL"

"Unë jam qytetar i gjithë botës.", ishte lajtmotivi i aktiviteteve që u zhvilluan me rastin e Ditës Evropiane të Gjuhëve në shkollën tonë. Zbukurimi i ambienteve të shkollës me punët dhe projektet e bëra nga nxënësit e klasave të 6-ta, të 7-ta, të 8-ta dhe të 9-ta, poezitë, këngët dhe esetë e interpretuara dhe shkruara nga nxënësit tanë në gjuhë të ndryshme evropiane, synojnë njohjen më të gjerë si në aspektin gjuhësor, ashtu dhe kulturor të shteteve të ndryshme të Evropës.





DITA E HAPUR NË LUFTËN KUNDËR BULLIZMIT

26 tetori ishte për shkollën tonë Dita e Hapur në luftën kundër ngacmimeve, lëndimeve apo siç njihet tashmë me termin e ndërkombëtarizuar, bullizmit, fenomen ky mjaft i përhapur te fëmijët, të rinjtë dhe më gjerë në shoqërinë tonë. Qëllimi kryesor ishte jo vetëm që të rriturit të njiheshin me punimet e nxënësve, por edhe të ndërgjegjësoheshin për pasojat që shkakton bullizmi te fëmijët e të rinjtë. Dita e Hapur e realizoi më së mirë qëllimin e saj, por nuk shënoi fundin e luftës ndaj bullizmit. Projekti do të vazhdojë me trajnime, seminare dhe aktivitete të tjera përgjatë gjithë vitit shkollor.

ROBOTIKA, LËNDA MË E RE MËSIMORE NË SHKOLLËN TONË



Këtë vit shkollor, në kolegjin "Turgut Özal", nga klasa e parë deri në klasën e pestë, zhvillohet mësimi i robotikës. Kjo lëndë realizohet në një kabinet të posaçëm të pajisur me robotë, të cilët ngjallin mjaft kuriozitet përballë syve kureshtarë të të vegjëlve. Nëpërmjet kësaj risie, shkolla jonë është ndër të parat shkolla që edukojnë brezat e ardhshëm me njohuri nga fusha e robotikës. Vetë fëmijët në bazë të dijeve që u jepen nëpërmjet programit të quajtur Scratch, praktikohen me montimin dhe çmontimin e robotëve. Synimi i kësaj lënde nuk është vetëm mësimdhënia, por njëkohësisht të nxisë bashkëpunimin dhe aftësitë krijuese të fëmijët.

ZBAVITEMI NË ORËN E ROBOTIKËS ME LOJËN E KODUAR

Fëmijët e presin me padurim orën e robotikës, sepse ajo jo vetëm u ofron lojëra të reja e mjaft zbavitëse, por edhe i mëson me njohuritë e duhura për t'u bërë ata vetë programues. Fëmijët punojnë me programin Scratch dhe njëkohësisht eksplorojnë lojërat që i tërheqin më tepër. Mjaft prej tyre kanë arritur të triumfojnë e ta çojnë deri në fund lojën e nisur.





KLASAT E 6-TA MBJELLIN LULE

Nxënësit e klasave të 6-ta u organizuan në një tjetër aktivitet gjatë muajit tetor, "Mbjelljen e luleve". Të gjithë nxënësit ishin kujdesur të sillnin bimë dhe lule të shumëllojshme. Plot energji, si një skuadër e vetme, bashkëpunuan për të krijuar një ambient edhe më të bukur, të shëndetshëm e mjaft çlodhës. Kjo veprimtari pati ndikim të madh dhe të gjithë e mbështetën nismën: "Ambiente të gjelbra, jetë më e shëndetshme!"

SI TË KUJDESEMI PËR DHËMBËT

Nxënësit e klasës së 3A zhvilluan një orë bisede me prindin e nxënësit Deon Xholi, me profesion stomatolog, për kujdesin që duhet të tregohet ndaj dhëmbëve. Përveç këshillave të vlefshme për të pasur dhëmbë sa më të shëndetshëm, dentisti u shpjegoi fëmijëve dhe rolin e aparatit të dhëmbëve kur ai është i nevojshëm për t'u përdorur. Kjo bisedë mjaft e dobishme, u mbyll me premtimin se ata, fëmijët, do të kujdeseshin gjithmonë për dhëmbët e tyre.



KLASAT E DYTA PROJEKTOJNË STINËN E VJESHTËS

“Modelojmë stinën e vjeshtës” ishte tema mësimore, në të cilën nxënësit e klasave të dyta realizuan projekte të ndryshme me gjethet e kësaj stine, të mbledhura nga vetë ata. Në këto projekte, talenti dhe fantazia, u shkrinë me larminë e ngjyrave të ëndrrave dhe lojërave të fëmijëve që u përcollën nga nuancat e ngjyrave të arta të vjeshtës. Veprimtari të tilla në shkollën tonë, kanë si qëllim të mësuarit e njohurive të reja të nxënësit, përmes argëtimit.



SHKOLLA JONË I BASHKOHET NISMËS “TË PASTROJMË SHQIPËRINË QË DUAM”

Nismës “Të pastrojmë Shqipërinë që duam”, iu bashkua dhe shkolla jonë. Për këtë qëllim në shkollën tonë u zhvillua një seminar i mbajtur nga Administratori i Eco Tirana, Z .Diego Testi, me temë “Të mbajmë pastër mjedisin”, ku morën pjesë nxënës të ciklit fillor. Synimi i veprimtarive të tilla është edukimi i brezave të rinj me ndjenjën e mbrojtjes dhe ruajtjes së mjedisit, duke përcjellë mesazhin se, të gjithë ne mund të bëjmë diçka për të përmirësuar mjedisin. E kush më mirë sesa fëmijët mund ta përcjellin këtë mesazh të gjithë ne.





NË ORËN E MËSIMIT TË PUNËS ME DRU

Disa copa dërrasash, pak ngjitës, një kabinet, një mësuese që frymëzon dhe fantazia e fëmijëve merr krahë e fluturon përtej mureve të shkollës. Pamja që të ofrohet gjatë kësaj ore mësimi, fytyrat e qeshura të nxënësve, bisedat plot entuziazëm, era e ngjitesit dhe zhurmat e dërrasave që kërcasin në çdo lëvizje të fëmijëve e shtojnë atmosferën e ngrohtë e bashkëpunuese në klasë. Ata formojnë shtëpiza kukullash, tavolina të vogla, mbajtëse lapsash, vazo lulesh, korniza të ndryshme etj. Me këto punime do të hapet një ekspozitë shitjeje, të ardhurat e së cilës do të shkojnë në ndihmë të familjeve në nevojë.

EDUKOHEMI NËPËRMJET ARTIT DHE KULTURËS

Kjo ishte tema e aktivitetit të zhvilluar nga shkolla jonë në bashkëpunim me Teatrin Kombëtar. Nxënësit e klasave të nënta, të përzgjedhur në bazë të dëshirës dhe pasionit të tyre në leximin e librave jashtëshkollorë, morën pjesë në një bisedë me një nga aktorët dhe regjizorët e Teatrit Kombëtar, Laert Vasili. Në bisedën e zhvilluar me të, u fol në lidhje me historinë e teatrit, emrat e mëdhenj të skenës së Teatrit Kombëtar, si dhe mbi dramën më të fundit, që është duke u shfaqur aty. Nxënësve iu dha mundësia të lexonin pjesë nga drama mjaft të njohura.





LOJËRAT E INTELIGJENCËS

Lojërat e inteligjencës zhvillohen në shkollën tonë si pjesë e socializimit më të gjerë të nxënësve mes njëri - tjetrit. Aftësitë që fitojnë nxënësit nga këto lojëra janë: thellim në mendim, zgjidhje problemesh, lehtësojnë komunikimin, zhvillojnë mendimin kritik, dëshirë dhe motivim për t'u perfeksionuar. Lojërat variojnë dhe janë të gjitha shumë të ndryshme.

Disa nga ato janë: Hanoi, Jenga, Nëntë gurët, Mangala dhe Shah.

TANGRAM

SËRISH NË TANGRAM



Edhe këtë vit shkolla jonë u përfaqësua denjësisht nga nxënësit e saj në emisionin "Tangram", programi zbavitës, edukues e promovues i talenteve të fëmijëve shqiptarë. Projektet, me të cilat u përfaqësuan nxënësit tanë, ishin mjaft interesante. Ato trajtonin tematika të cilat përfshinin që nga ndjenja e bamirësisë e deri te aftësitë e talentet e tyre krijuese.



MBRËMJA GALA

Mbrëmja gala e emisionit "Tangram" u organizua në sallën e koncerteve të shkollës "Turgut Özal". Në të morën pjesë nxënës të shkollave të ndryshme të Tiranës, pjesëmarrës në këtë program. Shkolla jonë u prezantua me videoklipin e këngës "Me Flamurin në Zemër" dhe një interpretim live nga nxënësja Emi Baloshi. Në mbyllje të kësaj mbrëmjeje u shpërndanë certifikata për të gjithë nxënësit pjesëmarrës në këtë emision.

Botimet 2017-2018





Memorial International School of Tirana offers:

Kindergarten

- . English medium education in small groups
- . International environment
- . UK curriculum, where prep year (parashkoll) is the first year of primary
- . Emphasis on personal development

Secondary

- . Excellence in English
- . Focus on 21st century skills (Critical thinking, Communication, Collaboration, Creativity)
- . Cambridge examinations: Checkpoint, IGCSE, A Level programs
- . Recognition worldwide
- . Preparation for "provimi i lirimit" and state "matura" examinations
- . Accredited by Ministry of Education and Cambridge International Assessment

Primary

- . Native English speaking teachers from UK, Canada, USA and Australia
- . Encouraging independent learners and thinking skills
- . Strong pastoral program
- . Albanian language lessons
- . Extra curricular activities, e.g. dance, chess, robotics, German, French, Spanish